



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800414/2

Tiranë ___/___/2018

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimit sikurse vendosur me Vendimin Gjyqësor të formës së prerë nr. 5133, datë 24.04.2014, prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.*

Drejtuar : **Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqëror**

TIRANË

Për dijeni : **Drejtorit të Përgjithshëm të Insitutit të Sigurimeve Shoqërore**

TIRANË

Z.Drejtor!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasit R.H., në të cilën ai ka prezantuar shqetësimin për mosrespektimin nga ana e organit që ju përfaqësoni të detyrimit të vendosur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me Vendimin Gjyqësor "Për lejimin e sigurimit të padisë", nr.80, datë 24.01.2018, me objekt:

*"Pranimin e kërkesës për sigurim padie të pales paditëse.
Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar veprimet e palës së paditur (Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë) në mbajtjen e diferencës debitoare, kundrejtë paditësit, deri në përfundimin e këtij gjykimi".*

Referuar deklarimeve të dhënë prej ankuesit, rezulton se, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, vijon kryerjen e ndalesave nga pensioni i pleqërisë së ankuesit, pa marrë parasysh detyrimin ligjor të vendosur nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, sipas vendimit gjyqësor të sipërcituar.

Referuar parashikimeve të nenit 510/a të Kodit të Procedurës Civile (K.Pr.C), se;

*"Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv.
Janë tituj ekzekutiv:*

- a) *Vendimet civile të formës së prerë, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;*
b)”,

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, ka detyrimin e moskryerjes së veprimeve për kryerjen e ndalesave nga pensioni mujor i pleqërisë që përfiton ankuesi, deri në përfundim të gjykimit të padisë nga ana e gjykatës dhe marrjes formë të prerë të vendimit.

Ankimi kundër Vendimit Gjyqësor “Për lejimin e sigurimit të padisë”, nr.80, datë 24.01.2018, të dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, nuk pezullon ekzekutimin e tij. Kjo situatë ligjore është e parashikuar në nenin 210 të K.Pr.C., apo nenin 32 të ligjit nr.32/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

se;

“Ankimi kundër vendimit që lejon masën e sigurimit, nuk pezullon ekzekutimin e tij. ...”.

Mosrespektimi i detyrimit sikurse vendosur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me Vendimin Gjyqësor “Për lejimin e sigurimit të padisë”, nr.80, datë 24.01.2018, është i dënueshëm prej Shërbimit të Përmabrimit Gjyqësor, referuar parashikimeve të nenit 606 të K.Pr.C., nëse ankuesi ka depozituar kërkesë pranë këtij Shërbimi për vënien në ekzekutim të tij.

Gjithashtu sjellim në vëmendje, se, neni 320 i Kodit Penal, i ndryshuar, parashikon se ;

“Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës.

Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës, ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

Qëndrimi i mbajtur prej organit që ju përfaqësoni në procesin e respektimit të detyrimit të vendosur sipas Vendimit Gjyqësor “Për lejimin e sigurimit të padisë”, nr.80, datë 24.01.2018, të dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, e vlerësojmë në cënim të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin 6/1 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.

Në procesin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor në fjalë, qëndrimi i organit që ju përfaqësoni, nuk duhet të cënoji marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni në fuqi.

Zhvillimi i veprimtarisë nga ana e organit që ju përfaqësoni në këtë çështje, duhet të kryhet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë objektivitetit, drejtësisë dhe paanësisë, sikundër parashikuar në K.Pr.Administrative dhe të detyrueshme në kuptim e zbatim të parashikimit të kryer në nenin 2 të këtij Kodi.

Ekzekutimi i titullit ekzekutiv përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësisë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Gjykata Kushtetuese, ka vlerësuar se, ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Mosrespektimi i së drejtës të ankuesit brenda afatit ligjor, nuk i shërben rritjes dhe përmirësimit të standarteve të shtetit ligjor, pasi ai ndikon në mosfinalizimin e procesit të dhënies së drejtësisë dhe sikundër kuptohet edhe nga ankesa e mësipërme, ul autoritetin e institucionit dhe krijon premisa për humbjen e besimit ndaj dhënies së drejtësisë, duke cënuar të drejtat dhe liritë e shtetasve të mbrojtura nga Kushtetuta dhe ligjet.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në vendimmarrjet e veta, lidhur me të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, ka theksuar se, shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktik do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet joefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë të gjatë. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese në vendimmarrjet e saj ka pranuar se : “...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në neni 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj”.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me neni 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe parashikimin e kryer në neni 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimit sikurse vendosur me Vendimin Gjyqësor “Për lejimin e sigurimit të padisë”, nr.80, datë 24.01.2018, të dhënë prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform neni 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKEMBI

Konceptoi dhe Daktilografoi

A.Gjoleka